



“Agrobiznesi nën fokusin e NOA-s”

PUBLIKIM KËSHILLIMOR

“Planifikimi në fermë dhe kultivimi i perimeve në sera”

NOA në bashkëpunim me ekspertë të fushës së bujqësisë dhe biznese eksportuese organizoi një seminar trajnimi me qëllim adresimin e rëndësisë së praktikave të mira bujqësore për fermerët që kultivojnë perimet në sera. Sesionet e seminarit u drejtuan nga lektorët, Prof. Enver Tome dhe Ilir Pilku.

Seminari u ndoq nga 25 fermerë nga rajoni i Lushnjes, Beratit dhe Fierit, njëkohësisht edhe klientë të NOA-s, që ushtrojnë aktivitetin e prodhimit të perimeve në sera. Qëllimi i seminarit ishte t'u jepte pjesëmarrësve njohuri mbi rëndësinë dhe domosdoshmërinë e planifikimit në fermë, metodat agroteknike të kultivimit në sera në mënyrë që të marrin vendime mbi planifikimin e drejtë të përdorimit të tokës, financave dhe kreditimit, për të rritur në mënyrë të qëndrueshme produktivitetin bujqësor. Pjesë e seminarit të organizuar ishin edhe tema mbi reduktimin e humbjeve ekonomike të fermerëve ndaj sëmundjeve tipike në serra dhe ndërtimi i kapaciteteve dhe qëndrueshmërisë së tyre për të zbutur ndikimet e ardhshme nga këto problematika të shfaqura. Ky sesion u dha pjesëmarrësve mundësi për të mësuar rreth rëndësisë së menaxhimit të integruar të dëmtuesve dhe detajet përkatëse që kërkohen të përdoren gjatë kontrollit të insekteve dhe sëmundjeve. Gjithashtu gjatë seancës Prof. Tome u përqendrua në shpjegimin mbi listën e insekteve dhe sëmundjeve që kanë ndikim negativ në prodhimin e kulturave.

Seminari u zhvillua përmes prezantimeve dhe ilustrimeve grafike dhe diskutimeve interaktive pas çdo prezantimi aktual.





“Agrobusiness under the focus of NOA”

ADVISORY POST

“Farm planning and growing vegetables in greenhouses”

The NOA in cooperation with experts in the field of agriculture and export businesses organized a training seminar to address the importance of good agricultural practices for farmers who grow vegetables in greenhouses. The seminar sessions were led by two lecturers, Prof. Enver Tome and Ilir Pilku.

The seminar was attended by 25 farmers from the regions of Lushnja, Berat and Fier, who are also clients of NOA, dealing with vegetable production activity in the greenhouses. The purpose of the seminar was to give to the participants knowledge on the importance and necessity of planning on the farm, information on agro-technical methods of cultivation in greenhouses in order to make decisions on the proper planning on the use of the land, as well as orientation on finance and lending, in order to increase sustainable agricultural productivity. During the seminar other topics were covered especially on reducing the farmers' economic losses towards typical diseases in the greenhouses and building their capacity and resilience to mitigate the future impacts of these issues. This session gave the participants the opportunity to learn about the importance of Integrated Pest Management and the relevant details required to be used during the insects and diseases control. During his session, Prof. Tome was also focused on the list of insects and diseases in the greenhouses and taught the farmers their negative impact on the crop production.

The seminar was conducted through graphic presentations and illustrations and interactive discussions after every presentation.

